



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Nr. 14

Datë: 02. 03. 2020. Ora: 15:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

**RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

**2. Aktivitetet e ZRPP-së;**

- Shqyrtim dhe miratimi i rekomandimit për akreditim të grupi të dytë të vëzhguesve për zgjedhjet jashtëzakonshëm për Kryetar në Komunën e Podujevës;

**3. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**

- **Këshilli për Operacionet Zgjedhore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për rritjen e numrit të votuesve për vendvotime, për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës;
- Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për certifikimin e Listës përfundimtare të votuesve për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës.
- Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit dhe përmbajtjes së fletëvotimit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën në Podujevës;

- Shqyrtimi dhe miratimi i caktimit të numrit të fletëvotimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës;

#### 4. Të ndryshme.

##### 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

**Valdete Daka:** Po fillojmë takimin, a ka dikush vërejtje, sugjerime...?

**Arianit Elshani:** Lidhur me informimin publik, mediat nuk janë prezent në mbledhjen e KQZ-së, duhet të jenë...!

**Yll Buleshkaj:** Me rregullore nuk kërkohet të jenë prezent, ne i lajmërojmë por mos prezenca e tyre nuk e pengon punën e KQZ-së...

**Valdete Daka:** Ne i lajmërojmë, a vijnë apo s'vijnë, është punë e tyre...

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

##### 2. Aktivitetet e ZRPP-së;

Shqyrtim dhe miratimi i rekomandimit për akreditim të grupi te dytë te vëzhguesve për zgjedhjet jashtëzakonshëm për Kryetar në Komunën e Podujevës

**Yll Buleshkaj:** Thirrjes sonë për aplikim për vëzhgues, i është përgjigjur ambasada amerikane në Kosovë, e cila ka dërguar aplikacionin për dy vëzhgues. Kriteret janë plotësuar në bazë të ligjit, dhe ne rekomandojmë për akreditim.

**Valdete Daka:** Kush është pra për akreditimin e këtyre dy vëzhguesve ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e ZRPP-së për akreditim të grupi te dytë te vëzhguesve për zgjedhjet jashtëzakonshëm për Kryetar në Komunën e Podujevës.

##### 3. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

###### **Këshilli për Operacionet Zgjedhore:**

1.Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për rritjen e numrit të votuesve për vendvotime, për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës:

**Alim Rama:** KOZ-i, i ka shqyrtuar përgatitjet për proces kështu që në pikën e parë e kemi, shqyrtimin dhe miratimin e rekomandimit për rritjen e votuesve për vendvotime për gjendjen e jashtëzakonshme për kryetar për komunën e Podujevës sipas ligjit numri i votuesëve brenda vendvotimit është 750 por në praktikën e deritanishme të KQZ-së ky numër është rritur deri në 950 duke pasur parasysh daljen e cila është 30-40% KOZ-i, e ka miratuar dhe e rekomandon për miratim vendimin që e keni përpara.

**Arianit Elshan:** Ashtu siç e kam potencuar edhe pse kam votuar pro këtij rekomandimi të rritet në 950 është krijuar si praktik të rritet është mirë edhe si komision e sqarojë Besi se kanë diskutuar edhe me akterët e tjerë relevant lidhur me rregullimin e listave të votueseve me vendbanim dhe adresë të saktë të personave që votojnë të jemi edhe ne brenda ligjit që na specifikon duhet të jetë me 750 por mund ta rrisim me vendim të komisionit por duhet të kemi parasysh që kemi shumë qendra të votimit me shumë klasë shumë numra të vendvotimit e përmendëm edhe në mbledhjen e KOZ-i rastin e vendvotimit në Gjakovë edhe këtu kemi bërë shkollë ekonomike ku ka shumë vendvotime. Mendo se pas këtyre zgjedhjeve të kërkojmë dhe të përkushtohemi maksimalisht ti rregullojmë këto lista të votuesve me adresë të saktë të banimit që të zhvendosen në qendrat e tyre më të afërta të votimit.

**Valdete Daka:** Këshilli i ka shqyrtuar këto çështje, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, aprovuan këtë rekomandim.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për certifikimin e Listës përfundimtare të votuesve për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës:

**Alim Rama:** E keni raportin të cilin këshilli e ka shqyrtuar dhe miratuar, po ashtu, edhe Sekretariati i ka kryer të gjitha përgatitjet: njëherë e ka publiku listën preliminare, tash edhe listën përfundimtare. I ka bërë edhe korrigjimet e nevojshme, dhe duke i marrë parasysh të gjitha këto përgatitje, rekomandon KQZ-në që ta certifikoj Listën përfundimtare të votuesve për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës

**Valdete Daka:** Sa votues ka lista...?

**Sami Hamiti:** 86 610 votues...

Anëtarët e KQZ-së, aprovuan këtë rekomandim.

3.Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit dhe përmbajtjes së fletëvotimit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën në Podujevës:

**Alim Rama:** Përpara jush e keni dizajnin e Fletëvotimit, duke marrë parasysh edhe radhitjen që është bërë sot. E keni nga një kopje, këshilli nuk ka pas vërejtje dhe ne rekomandojmë për aprovim...

Anëtarët e KQZ-së, aprovuan këtë rekomandim.

4.Shqyrtimi dhe miratimi i caktimit të numrit të fletëvotimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës:

**Alim Rama:** Po ashtu, kemi shqyrtuar edhe caktimin e numrit të fletëvotimeve që duhet të prodhohen për këto zgjedhje, e ku aplikohen formulat që janë aplikuar deri tani që në vendvotimet e rregullta numri i votuesve ka me qenë më i vogël se numri në total: për shembull, nëse numri është 840, kanë me u shtypë 700 fletëvotime në atë vendvotim. Kurse te vendvotimet e dyfishta, ky numër zvogëlohet për 49... Kjo ka qenë praktikë e deritashme, në esencë ka qenë kursim i çmimit...

**Valdete Daka:** Ligji thotë plus 10 %, por edhe këto janë shumë...

#### 4. **Të ndryshme !**